

VENDIM
Nr.356, datë 14.6.2006

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.324, DATË 21.5.2004 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR FUNKSIONET DREJTUESE
DHE PËR STRUKTURËN E NIVELET E PAGAVE NË MINISTRINË E PUNËVE TË
JASHTME”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, të nenit 45 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.324, datë 21.5.2004 të Këshillit të Ministrave, në pikën 1, lidhja nr.1 zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2006, të përballohen nga fondet e planifikuara për rritjen e pagave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

POZICIONI DREJTUES	GRADA DIPLOMATIKE	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA PËR GRADË
	1	2	3	4	5
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHK)	Shtesa për kualifikim (SHP)	Shtesa për pozicion (SHP) lekë
Sekretar i Përgjithshëm	Ambasador	10.050	2%	0	108 570
Drejtor i Përgjithshëm	Ministër Fuqplotë Ministër Këshilltar Konsull i Përgjithshëm	10.050	2%	0	97 713
Drejtor	Këshilltar	10.050	2%	0	80 342
Përgjegjës sektori	Sekretar i parë Konsull	10.050	2%	0	59 714
	Sekretar i dytë Zëvendëskonsull	10.050	2%	0	43 428
	Sekretar i tretë Agjent konsullor	10.050	2%	0	32 571
	Atashe	10.050	2%	0	21 714